

Korniza e Sigurimit të Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian



EUROPEAN
STATISTICAL
SYSTEM

Versioni 1.1

Korniza e Sistemit të Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Korniza e Sigurimit të Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian (ESS QAF).....	6
Ambienti Institucional.....	6
Parimi 4: Përkushtimi ndaj cilësisë	6
Proceset statistikore.....	9
Parimi 7: Metodologjia e duhur	9
Parimi 8: Procedurat e përshtatshme statistikore.....	12
Parimi 9: Ngarkesa jo e tepërt e të anketuarve.	16
Parimi 10: Kost efektiviteti	19
Rezultati statistikor	21
Parimi 11: Relevanca.....	21
Parimi 12: Saktësia dhe besueshmëria.....	22
Parimi 13: Afati kohor dhe saktësia	24
Parimi 14: Koherenca dhe krahasueshmëria.	26
Parimi 15: Qasja dhe qartësia	28
Aneksi. Dokumentacioni reference	31

Hyrje

Me qëllim të mbështetjes së implementimit të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane (CoP), rishikuar nga Sponzorizimi mbi Cilësinë, është përgatitur një dokument mbështetës – Korniza e Sigurimit të Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian (SSE). Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE identifikon aktivitetet e mundshme, metodat dhe mjetet, që mund të ofrojnë udhëzime dhe evidencë për implementimin e indikatorëve, d.m.th. ndihmon në marrjen e hapave të nevojshëm për operacionalizimin e indikatorëve, që kërkohet të arrihen në kuadër të secilit parim të CoP. Derisa CoP rregullon parimet dhe indikatorët si standarde kundrejt të cilave vlerësohet përputhshmëria/pajtueshmëria e autoriteteve statistikore kombëtare dhe të komunitetit përmes rishikimeve profesionale (peer review) dhe formave të tjera të vlerësimit. Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE përshkruan, për secilin indikator, aktivitetet, metodat dhe mjetet, që ndihmojnë implementimin e CoP. Në përputhje me programin e punës të 'Sponsorship', Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE është zhvilluar për të përkrahur implementimin e parimit 4 dhe 7 deri te parimi 15 i Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane, të adaptuara nga Komiteti i Sistemit të Statistikave Evropiane me 28 Shtator të vitit 2011.

Qasja e ndjekur

Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE në mënyrë sistematike, nga parimi deri te indikator, përmban rekomandimet mbi aktivitetet, metodat dhe mjetet e definuara në qasjen e orientuara në veprime, që ndihmon implementimin praktik dhe efektiv të indikatorit. Kjo reflekton një përpilim të qëndrueshëm të aktiviteteve, metodave dhe mjeteve tashmë të përdorura nga anëtarët e Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE). Megjithatë, është një dokument që vazhdimisht pëson ndryshime dhe përmirësime, me shtimin e aktiviteteve të reja, që zhvillohen nga autoritetet statistikore të SSE-së.

Aktivitetet, metodat dhe mjetet e rekomanduara duhet të konsiderohen si pjesë e evoluimit dhe zgjerimit të një grupi të instrumentesh, me progresin në implementimin e Kodit të Praktikës dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive. Ato duhet të ndihmojnë për të kuptuar se çfarë nevojitet për të plotësuar kërkesat e Kodit, p.sh. cilat 'aktivitete' rekomandohen të ndërmerren në mënyrë që të sigurohet implementimi i një indikatorit të caktuar.

Përveç kësaj, këto aktivitete, metoda dhe mjete të rekomanduara janë dizajnuar në atë mënyrë, që nuk janë të varura nga format organizative që ekzistojnë në Vendet Anëtare dhe shpesh mbështeten nga shembuj specifikë, që kanë funksionuar shumë mirë në disa vende. Të gjitha këto aktivitete, metoda dhe mjete, që janë identifikuar, në lidhje me praktikën ekzistuese tashmë implementohen në disa Insitute Statistikore Kombëtare, ku është dëshmuar të jenë të dobishme.

Në përgjithësi Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE mund të përdoret nga aktorë të ndryshëm që marrin pjesë në prodhimin dhe diseminimin e Statistikave Evropiane, për shembull autoritetet statistikore ose prodhues tjerë kombëtar,

edhe pse mund të nevojiten disa adaptime. Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE është dizajnuar nën supozimin që do të shkojë përtej indikatorëve të Kodit të Praktikës, duke u munduar të shtojë shpjegime dhe detaje. Si rezultat, përzgjedhja e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve, që të jenë direkt të lidhura me një nivel të caktuar të pajtueshmërisë, nuk është e thjeshtë edhe nëse Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE përkrah këtë.

Organizimi i Kornizës së Sigurimit të Cilësisë të SSE

Aktivitetet, metodat dhe mjetet e rekomanduara që janë përdorur për të përkahur secilin indikator, janë identifikuar në nivel institucional dhe në nivel produkti/ankete, ku është e aplikueshme, duke reflektuar nivelin e adaptimit dhe përdorimit. Ato paraqiten nga një përshkrim i përgjithshëm në atë më konkret dhe më të detajuar. Meqenëse disa indikatorë në Kodin e Praktikës janë vetë rekomandime, aktivitetet mbështetëse, metodat dhe mjetet mund të jenë më të detajuara dhe të natyrës më specifike, në mënyrë që të lehtësojnë implementimin e indikatorit.

Natyra e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të rekomanduara mund të çojë në përdorimin e shumëfishtë të tyre në mbështetjen e indikatorëve të ndryshëm. Në fakt një aktivitet/metodë/mjet/ i dhënë mund t'i ofrojë përkrahje të gjithë indikatorëve, të lidhur me një parim. Me qëllim të asistimit të implementimit të secilit aktivitet, metodë dhe mjet të rekomanduar, në aneks është paraqitur dokumentacioni relevant i referencave, duke lënë hapësirë për secilin autoritet statistikor të shtojë dokumentacionin e vet specifik.

Natyra dhe qëllimi i Kornizës së Sigurimit të Cilësisë të SSE

Korniza e Sigurimit të Cilësisë është një dokument i vet-qëndrueshëm, që është shumë i lidhur me Kodin e Praktikës, edhe pse nuk është pjesë integrale e tij. Është një mjet udhëzimi, që asiston implementimin e Kodit të praktikës nga ana e autoriteteve statistikore në nivel vendi (përfshirë prodhuesit e tjerë kombëtarë) dhe në nivel Evropian, duke u bërë një instrument i rëndësishëm i SSE-së. Natyra e hapur dhe fleksibile e kësaj kornize mundëson selektimin specifik të aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të rekomanduara, që i përshtaten më së miri kontekstit të një autoriteti specifik statistikor.

Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE mbetet e hapur dhe fleksibile në zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve, metodave dhe mjeteve në mënyrë që të mbështetet diversiteti dhe karakteristikat specifike të anëtarëve të SSE-së, si dhe të trajtohen aranzhimet e ndryshme kombëtare sa i përket prodhuesve të tjerë statistikorë. Do të vendosen procedurat bashkëpunuese, për të lehtësuar përditësimin e vazhdueshmëm të kornizës. Korniza e Sigurimit të Cilësisë mund të asistojë po ashtu monitorimin dhe implementimin e Kodit të Praktikës përmes rishikimeve profesionale dhe formave të tjera të vlerësimit në të ardhmen.

Grupi punues mbi Cilësinë e Statistikave ka vendosur një task forcë për të zhvilluar dhe përmirësuar më tej versionin e parë të Kornizës së Sigurimit të Cilësisë. Ky dokument është rezultat i diskutimeve të mbajtura nga task forca dhe grupi punues. Për shkak të natyrës së hapur dhe fleksibile të kësaj kornize, grupi punues ka vendosur të bëjë një rishikim vjetor, për të përditësuar përmbajtjen, nëse është e nevojshme.

Parimet e mbuluara nga Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE

Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE mbulon të gjitha parimet e Kodit të Praktikës, që janë të lidhur me proceset statistikore (parimet 7 deri 10) dhe outputet statistikore (parimet 11 deri 15). Parimi 4 – Përkushtimi ndaj Cilësisë, që është pjesë e parimeve të ambientit institucional, po ashtu është i përfshirë, pasi përbën një pjesë të rëndësishme dhe fundamentale të parimeve të lartpërmendura.

Pesë parimet e mbetura të Kodit të Praktikës nuk janë zhvilluar më tej në Kornizën e Sigurimit të Cilësisë të SSE pasi ato janë të lidhura me implementimin e Commission Communication 211/2011: 'Drejt menaxhimit të fuqishëm të cilësisë për Statistikat Evropiane'. Përveç rishikimit të Kodit të Praktikës, të lartpërmendur, Commission Communication propozon:

Një amandament specifik të Rregullores 223/2009 mbi Statistikat Evropiane.

Elaborimin e Përkushtimit ndaj Besueshmërisë së Statistikave me secilin Vend Anëtar

Një vendim të ri të Komisionit mbi rolin e Eurostat-it

Si përfundim, Korniza e Sigurimit të Cilësisë e SSE mbulon 10 parimet e mëposhtme të Kodit të Praktikës:

Ambienti institucional:

P4 – Përkushtimi ndaj

Cilësisë

Proceset statistikore:

P7 – Metodologjia e duhur

P8 – Procedurat e duhura statistikore

P9 – Barrë jo e tepërt për të anketuarit

P10 – Kostoja efektive

Produkti statistikor:

P11 – Relevanca

P12 – Saktësia dhe besueshmëria

P13 – Afatet kohore dhe

përpikëria

P14 – Koherenca dhe

krahasueshmëria

P15 – Qasja dhe qartësia

1 Qershor 2012

Korniza e Sigurimit të Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian

Ambienti Institucional

Faktorët institucionalë dhe organizativë kanë ndikim të fuqishëm në efikasitetin dhe kredibilitetin e autoritetit statistikor, që zhvillon, prodhon dhe diseminon Statistikat Evropiane. Çështjet relevante janë pavarësia profesionale, mandati për grumbullimin e të dhënave, mjaftueshmëria e resurseve, përkushtimi ndaj cilësisë, konfidencialiteti statistikor, pa anësia dhe objektiviteti.

Parimi 4: Përkushtimi ndaj Cilësisë.

Autoritetet statistikore janë të përkushtuar për cilësi. Ato identifikojnë në mënyrë sistematike dhe të rregullt përparësitë dhe dobësitë, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së procesit dhe produktit.

Indikatori 4.1: Politika mbi cilësinë është definuar dhe është në dispozicion për publikun. Ekzistojnë struktura organizative dhe mjetet për menaxhimin e cilësisë.

Metodat në nivel institucional

- 1. Deklarata e përkushtimit për cilësi.** Deklarata e Përkushtimit për Cilësi është në dispozicion për publikun, dhe përfshin parimet dhe përkushtimet, që kanë të bëjnë me cilësinë e statistikave, dhe janë në përputhje me qëllimet e përcaktuara në deklaratat e misionit dhe vizionit.
- 2. Struktura organizative për menaxhimin e cilësisë.** Ekziston një strukturë e qartë organizative për menaxhimin e cilësisë në kuadër të autoritetit statistikor. Shembuj të strukturave të tilla janë:
 - Komiteti i Cilësisë;
 - Menaxheri i Cilësisë;
 - Njësia e Centralizuar e Cilësisë;
 - Struktura të tjera (p.sh. një grup i caktuar i stafit të trajnuar si 'pilotë të cilësisë', për të vepruar si udhëheqës/këshilltarë të projektit/proceseve).
- 3. Definimi i udhëzuesve të Cilësisë.** Udhëzuesit definojnë për të përcaktuar se si të implementohet menaxhimi i cilësisë në kuadër të procesit të prodhimit statistikor, duke përfshirë:
 - Përshkrimin e procesit të prodhimit statistikor dhe identifikimin e dokumenteve për secilën fazë, duke u bazuar në Modelin e Procesit të Prodhimit të Statistikave ose ndonjë proces tjetër ekuivalent;
 - Përshkrimin e metodave për monitorimin e cilësisë së secilës fazë të procesit të prodhimit statistikor.

¹ Autoriteti Statistikor nënkupton Eurostat-in, institutet statistikore kombëtare (ISK) dhe autoritetet e tjera kombëtare, përgjegjëse për zhvillimin, prodhimin dhe diseminimin e statistikave Evropiane, aty ku vlen (cf. Rregullorja (EC) Nr 223/2009, Nenet 4 dhe 5).

4. **Udhëzuesit e Cilësisë në dispozicion.** Udhëzuesit e cilësisë, siç ceket më lart, janë në dispozicion për të gjithë përdoruesit, qoftë edhe vetëm në formë të përmbledhur.
5. **Infrastruktura për dokumentacionin.** Ekziston një infrastrukturë e përshtatshme, që mundëson përditësimin e dokumentacionit mbi cilësinë.
6. **Kurset e trajnimit.** Ka kurse specifike trajnimi, në baza të rregullta, në mbështetje të politikave të cilësisë, për stafin relevant.

Indikatori 4.2: Janë vendosur procedurat për planifikimin dhe monitorimin e cilësisë së procesit të prodhimit statistikor.

Metodat në nivel institucional

1. **Përkrahja metodologjike, teknike dhe mjetet e përgjithshme.** Ekziston përkrahje metodologjike dhe teknike dhe mjetet e përgjithshme nga njësitë e specializuara, kryesisht ato të Cilësisë, Metodologjisë dhe TI-së, për implementimin e monitorimit të cilësisë/planit të sigurimit të cilësisë.

Metodat në nivel produkti/ankete

2. **Procedurat për monitorimin e cilësisë së procesit.** Janë vendosur procedurat për monitorimin e cilësisë së fazave të ndryshme të prodhimit statistikor, p.sh. sipas planit për sigurimin e cilësisë ose një skeme të ngjashme, siç është planifikimi i takimeve të rregullta të grupit të ekspertëve.
3. **Plani i sigurimit të cilësisë.** Plani i sigurimit të cilësisë, ose një skemë tjetër e ngjashme, përshkruan standardet e punës, obligimet formale (siç janë ligjet dhe rregullat e brendshme) dhe një numër veprimesh të kontrollit të cilësisë për të parandaluar dhe monitoruar gabimet, për të vlerësuar indikatorët e cilësisë dhe për të kontrolluar çështje të ndryshme në secilën fazë të procesit statistikor.

Plani i sigurimit të cilësisë ose një skemë tjetër e ngjashme:

- merr për bazë nevojat e përdoruesve dhe e kontrollon relevancën e procesit statistikor; siguron dizajn teknik dhe organizativ efektiv;
- siguron cilësinë e grumbullimit të të dhënave, përfshirë përdorimin e të dhënave administrative;
- siguron cilësinë e trajtimit të të dhënave (kodimin, editimin, imputimin dhe vlerësimin); siguron analizimin sistematik të balancës midis lëshimeve dhe përfitimeve në kuadër të cilësisë;
- mundëson qasjen dhe krahasueshmërinë e informatave për përdoruesit dhe mbledh mendimet/përshtypjet e tyre;
- siguron metadata të përshtatshme për përdoruesit për të ndihmuar ata të kuptojnë cilësinë.

Indikatori 4.3: Cilësia e produktit vazhdimisht monitorohet, vlerësohet në kuptimin e përfitimeve dhe lëshimeve dhe raportohet sipas kritereve të Statistikave Evropiane.

Metodat në nivel institucional

1. **Procedurat për monitorimin e cilësisë së produktit.** Janë vendosur procedurat bazuar mbi raportimin e cilësisë, me qëllim të monitorimit të brendshëm të cilësisë së produktit. Rezultatet analizohen në baza të rregullta dhe infomohet menaxhmenti në mënyrë që të marrë vendimet në lidhje me përmirësimin e veprimeve.
2. **Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve.** Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve ose ndonjë metodë tjetër implementohet në baza të rregullta dhe rezultatet e tyre bëhen publike

dhe inkorporohen, kur është e mundur, në Raportet e Cilësisë, pasi ato monitorojnë 'Relevancën' përveç dimensioneve të tjera.

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Raportet e cilësisë të orientuar drejt përdoruesit.** Janë në dispozicion për publikun raportet e cilësisë të orientuara drejt përdoruesit.
4. **Raportet e cilësisë të orientuara drejt prodhuesve.** Raportet e cilësisë të orientuara drejt prodhuesve publikohen në baza të rregullta (periudha të përcaktohet: p.sh. nga Rregullorja specifike dhe cikli i jetës së anketës), duke pasë për bazë standardet për metadat referuese dhe indikatorët e cilësisë, në veçanti SIMS.
5. **Monitorimi i cilësisë së produktit.** Raportimet e cilësisë për përdoruesit dhe prodhuesit, përdoren për monitorimin e rregullt të cilësisë.

Indikatori 4.4: Ka një rishikim të rregullt dhe të plotë të produkteve (outputeve) kryesore statistikore, duke angazhuar edhe ekspertë të jashtëm, kur është e përshtatshme.

Metodat në nivel institucional

1. **Një plan për implementimin e Rishikimeve të Cilësisë.** Është definuar/implementuar një plan i përshtatshëm për implementimin e Rishikimeve të Cilësisë (siç është Auditimi dhe Vetëvlerësimi), në baza të rregullta për produktet kryesore statistikore, dhe, në mënyrë sistematike, në rast të riorganizimit të proceseve.
2. **Një strukturë për Rishikimet e Cilësisë.** Është vendosur një strukturë e përshtatshme për realizimin e Rishikimeve të Cilësisë për auditim të brendshëm dhe vetëvlerësime.
3. **Trajnimi i auditorëve të brendshëm.** Auditorët e brendshëm trajnohen për teknikat dhe sjelljet e auditimit.
4. **Dokumentacioni referues.** Rishikimet e cilësisë kanë si dokumentacion referues:
 - Udhëzuesin e cilësisë/planin e sigurimit të cilësisë, ose ngjashëm;
 - Raportet e cilësisë të orientuara drejt prodhuesve dhe/ose raportet e cilësisë të orientuara drejt përdoruesve;
 - Pyetësorët e Vetëvlerësimit të plotësuar nga prodhuesit;
 - Raportet nga intervistat e auditorëve;
 - Pyetësorët e plotësuar nga të anketuarit dhe/ose përdoruesit;
 - Çdo studim tjetër mbi kënaqshmërinë
5. **Planet e veprimit.** Gjetjet e rishikimeve të cilësisë rezultojnë në zhvillimin e planeve të veprimit.
6. **Mendimet/përshtypjet e përdoruesve.** Mendimet e përdoruesve të ndryshëm përdoren si kontribute/inputs në zhvillimin e planeve vepruese (duke përdorur Anketat e Kënaqshmërisë së Përdoruesve ose fokus grupet)
7. **Angazhimi i ekspertëve të jashtëm.** Ekspertët e jashtëm angazhohen për të analizuar fushat kryesore statistikore (p.sh. Rishikimi i Standardeve dhe Kodeve (ROSC) nga FMN-ja).
8. **Standardet/pike referimi ('benachmarking').** Janë vendosur standardet/pikë referimi për proceset statistikore kryesore me autoritetet e tjera statistikore me qëllim të identifikimit të praktikave të mira.

Proceset statistikore

Standardet evropiane dhe standardet e tjera ndërkombëtare, udhëzuesit dhe praktiket e mira janë referuese në proceset që autoritetet statistikore përdorin për organizimin, grumbullimin, procesimin dhe diseminimin e Statistikave Evropiane. Kredibiliteti i statistikave është ngritur për arsye të menaxhimit të mirë dhe efikasitetit. Aspektet relevante janë metodologjia e duhur, procedurat e duhura statistikore, ngarkesa jo e tepruar e të anketuarve dhe kostë efektiviteti.

Parimi 7: Metodologjia e duhur.

Metodologjia e duhur fuqizon cilësinë e statistikave. Kjo kërkon mjetet procedurat dhe ekspertizën adekuate.

Indikatori 7.1: Korniza e përgjithshme metodologjike e përdorur për Statistikat Evropiane i përmbahet standardeve evropiane dhe standardeve të tjera ndërkombëtare, udhëzuesve dhe praktikave të mira.

Metodat në nivel institucional

1. **Dokumentacioni standard mbi metodologjinë.** Korniza metodologjike dhe procedurat për implementimin e proceseve statistikore janë të integruara në një dokument standard mbi metodologjinë dhe rishikohet në mënyrë periodike.
2. **Shpjegimi i devijimit nga rekomandimet ndërkombëtare.** Devijimet nga rekomandimet metodologjike Evropiane dhe ndërkombëtare shpjegohen dhe justifikohen.

Indikatori 7.2: Janë vendosur procedurat për të siguruar që konceptet, definicionet dhe klasifikimet standarde aplikohen në mënyrë konsistente në tërë institucionin statistikor.

Metodat në nivel institucional

1. **Konceptet, definicionet dhe klasifikimet.** Konceptet, definicionet dhe klasifikimet janë të definuara nga Autoritetet Statistike, në përputhje me legjislacionin Evropian dhe/ose kombëtar dhe janë të dokumentuara.
2. **Infrastruktura metodologjike.** Ekziston një infrastrukturë metodologjike (p.sh. njësitë, rrjetet, komitetet), e cila definojnë metodat statistikore, monitoron implementimin e tyre dhe validon rezultatet. Në veçanti, definojnë dhe vë në dispozicion mjete standarde për secilën fazë të procesit të prodhimit statistikot (p.sh. mostra, grumbullimi dhe procesimi i të dhënave etj.).

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Pikëpamjet e ekspertëve dhe përdoruesve relevantë.** Anketat ose proceset statistikore mund të zhvillohen duke marrë mendimet e ekspertëve dhe të përdoruesve relevantë, aty ku është e mundur.

4. **Dokumentimi i metodologjisë.** Ekziston dokumentimi i metodologjisë për secilin proces statistikor, që përmban të gjitha informatat relevante mbi metadat, respektivisht konceptet, metodat, klasifikimet, dhe është publikuar, së paku në formë të përmbledhur.
5. **Pjesëmarrja në seminare dhe takime pune.** Stafi merr pjesë në seminare dhe takime pune në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në lidhje me aplikimin e standardeve, klasifikimeve etj.

Indikatori 7.3: Regjistri i biznesit dhe korniza për anketat e popullsisë vlerësohen dhe përmirësohen në baza të rregullta në mënyrë që të sigurohet cilësi e lartë.

Metodat në nivel produkti/ankete

1. **Procedura për përditësimin e regjistrit të bizneseve.** Ekziston një procedurë për përditësimin e regjistrit të biznesit me të gjitha ndryshimet relevante në popullacionin e bizneseve (p.sh. ndryshimi i aktivitetit, lindjet, vdekjet, bashkimet, blerjet dhe ndryshimet e tjera strukturore, si dhe ndryshimet e variablave kryesore). Ky përditësim realizohet në mënyrë të vazhdueshme.
2. **Vlerësimi cilësor i regjistrit të bizneseve.** Regjistri i bizneseve i nënshtrohet një anketimi/vlerësimi të rregullt mbi cilësinë/ose vlerësohen dhe kalkuloohen indikatorët e cilësisë.
3. **Procedura për përditësimin e regjistrit të ekonomive familjare.** Për anketat e ekonomive familjare, korniza relevante e popullsisë përdirësohet rregullisht dhe mjaftueshëm shpesh për të siguruar cilësinë e mostrave.
4. **Përdorimi i informacioneve nga anketat.** Informacionet e mbledhura gjatë implementimit të anketës përdoren për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e kornizës, sidomos mbulueshmërinë e saj.

Indikatori 7.4: Ekziston një harmonizim i detajuar në mes të sistemeve kombëtare të klasifikimeve dhe sistemeve Evropiane korresponduese.

Metodat në nivel produkti/ankete

1. **Konsistenca e klasifikimeve kombëtare.** Klasifikimet kombëtare janë konsistente me sistemet Evropiane të klasifikimit.
2. **Tabelat korresponduese.** Tabelat korrespondente janë të dokumentuara dhe përdirësohen. Vërejtjet ose komentet shpjeguese janë në dispozicion për publikun.

Indikatori 7.5: Janë punësuar të diplomuarit në fusha akademike relevante.

Metodat në nivel institucional

1. **Punësimi i stafit.** Stafi në institucionin statistikor punësohet me konkurs të hapur dhe me kualifikimet adekuate në fushat relevante.
2. **Kualifikimet e kërkuara për pozitat.** Janë të specifikuara kërkesat për kualifikimet e nevojshme për të gjitha pozitat.

Indikatori 7.6: Autoritetet statistikore implementojnë një politikë për trajnimin e vazhdueshëm profesional për stafin e tyre.

Metodat në nivel institucional

1. **Procedura për trajnimin e stafit.** Ekziston një strukturë dhe procese të rregullta, që sigurojnë trajnimin e vazhdueshëm profesional të stafit, dhe janë pjesë përbërëse e procedurave të burimeve njerëzore.
2. **Trajnimi i vazhdueshëm profesional.** Trajnimi i vazhdueshëm profesional inkurajohet dhe çmohet në rrugën e zhvillimit në karrierë.
3. **Përditësimi i njohurive të stafit.** Njohurit e stafit përditësohen në lidhje me instrumentet e reja në fushat përkatëse.
4. **Pjesëmarrja e stafit në trajnime.** Inkurajohet pjesëmarrja e stafit në trajnime relevante kombëtare dhe/ose Evropiane, ose në konferenca të tjera ndërkombëtare.

Indikatori 7.7: Organizohet një bashkëpunim me komunitetin shkencor për të përmirësuar metodologjinë, efikasitetin e metodave të implementuara dhe për të promovuar metoda më të mira, kur është e mundur.

Metodat në nivel institucional

1. **Kontaktet me komunitetin shkencor.** Ekzistojnë kontakte të rregullta, p.sh. përmes konferencave, seminareve, task forcave me komunitetin shkencor për të diskutuar metodologjinë, TI-në dhe zhvillimet e reja.
2. **Bashkëpunimi me kolegët në nivel ndërkombëtar.** Stafi bashkëpunon me kolegët ndërkombëtarë në lidhje me çështjet metodologjike.
3. **Pjesëmarrja dhe prezantimet në konferenca.** Inkurajohet pjesëmarrja dhe prezantimet në konferenca relevante kombëtare dhe ndërkombëtare, për shkëmbim të njohurive dhe përvojave.
4. **Organizimi i konferencave.** Organizohen konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ku inkurajohet pjesëmarrja e autoriteteve statistikore të SSE.

Metodat në nivel produkti/ankete

5. **Vlerësimi i jashtëm.** Ekspertë të jashtëm kërkohen për të bërë evaluimet/vlerësimet/auditimet e metodave të përdorura, kur është e mundur.

Parimi 8: Procedurat e përshtatshme Statistike.

Procedurat e përshtatshme statistikore të implementuara nga grumbullimi i të dhënave deri te validimi i tyre, fuqizojnë cilësinë e statistikave.

Indikatori 8.1: Kur Statistikat Evropiane bazohen në të dhënat administrative, definicionet dhe konceptet e përdorura për qëllime administrative janë të përafërta me ato që përdoren për qëllime statistikore.

Metodat në nivel institucional

1. **Përgjegjësia për procesimin statistikor të të dhënave administrative.** Autoriteti statistikor është përgjegjës për procesimin statistikor të të dhënave administrative që përdoren për Statistikat Evropiane.
2. **Dallimi në mes të procesimit të të dhënave statistikore dhe administrative.** Procesimi statistikor shumë ndahet qartë nga procesimi i të dhënave administrative dhe përfshin rregullat e duhura të validimit dhe procedurat specifike për kontrollimin e cilësisë.

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Dokumentacioni për proceset administrative dhe statistikore.** Ekziston dokumentacioni, që përshkruan dallimet midis proceseve administrative dhe statistikore në kuptimin e definicioneve, koncepteve, mbulueshmërisë etj.
4. **Studimet në lidhje me ndryshimet në koncepte dhe masat e marra për trajtimin e këtyre ndryshimeve.** Dallimet në koncepte analizohen thellësisht dhe ndërmerren masat e duhura për trajtimin e këtyre ndryshimeve, kur është e mundur.

Indikatori 8.2: Në rast të anketave statistikore, pyetësorët testohen në mënyrë sistematike, para grumbullimit të të dhënave.

Metodat në nivel institucional

1. **Procedura për të vlerësuar dhe validuar pyetësorët.** Ekziston një procedurë për vlerësimin dhe validimin e pyetësorëve dhe përfshin ekspertët relevantë (p.sh. në fushën statistikore dhe në dizajnimin e pyetësorit).

Metodat në nivel produkti/ankete

2. **Testimi i pyetësorit.** Para grumbullimit të të dhënave, pyetësorët për anketim testohen me metoda të përshtatshme (para testimit të pyetësorit, aktivitetet pilot në situata reale, intervista, fokus grupe, ofrimi ndihmë intervistuesit, etj.). Në këtë fazë vlerësohet edhe koha e përgjigjes (kohëzgjatja e intervistës), nëse është e nevojshme.
3. **Përdorimi i rezultateve të testimit.** Rezultatet e testimit merren për bazë në procesin e implementimit të pyetësorit final dhe të njëjtat dokumentohen në një raport.

Indikatori 8.3: Dizajnet e anketës, përzgjedhjet e mostrës dhe metodat e vlerësimit janë mirë të rregulluara dhe rishikohen në baza të rregullta dhe kontrollohen sipas nevojës.

Metodat në nivel institucional

1. **Struktura organizative për udhëzuesit, metodologjitë dhe kontrollimin e metodave të përdorura.** Ekziston një strukturë adekuate organizative, që ofron udhëzues, rekomandon metodologjitë e përshtatshme dhe kontrollon, në mënyrë periodike, metodat e përdorura për mostrën e anketës, përzgjedhjet e mostrave dhe metodat e vlerësimeve.
2. **Raportimi publik i metodave.** Autoriteti statistikor raporton publikisht mbi përzgjedhjen e mostrës dhe metodat e vlerësimeve.

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Përputhshmëria e dizajneve të anketës dhe përzgjedhjes së mostrave me standardet.** Dizajnet e anketës dhe përzgjedhjet e mostrave zhvillohen sipas metodave standarde.
4. **Rishikimi i dizajnit të mostrës.** Dizajnet e mostrave rishikohen në mënyrë periodike për anketat e rregullta.
5. **Metodat e krahasueshme për kalkulimin e saktësisë.** Metodat për kalkulimin e saktësisë të të dhënave statistikore mundësojnë krahasimin e saktësisë së Statistikave Evropiane.
6. **Matjet dhe raportimet e precizitetit të mostrës.** Vlerësimet e precizitetit të mostrës maten siç duhet dhe u raportohen përdoruesve.
7. **Rregullat metodologjike të aplikuara në vlerësime.** Metodat e vlerësimeve, përfshirë korrigjimin për mos-përgjigjet, kalibrimi i të dhënave dhe përshtatja sezonale iu përmbahen rregullave metodologjike transparente.

Indikatori 8.4: Grumbullimi i të dhënave, futja e të dhënave dhe kodimi monitorohen dhe rishikohen rregullisht, sipas nevojës.

Metodat në nivel institucional

1. **Struktura organizative për udhëzuesit, metodologjitë dhe analizimet e metodave të përdorura.** Ekziston një strukturë e përshtatshme organizative, që ofron udhëzues, rekomandon metodologjitë e përshtatshme dhe analizon në mënyrë sistematike metodat e përdorura për grumbullimin, futjen dhe kodimin e të dhënave.

Metodat në nivel produkti/ankete

2. **Optimizimi i grumbullimit të të dhënave.** Grumbullimi i të dhënave optimizohet me qëllim të reduktimit të kostos dhe ngarkesës së të intervistuarve, përmirësimit të saktësisë dhe reduktimit të gabimeve, që nuk lidhen me mostrën.
3. **Ofrimi i dokumenteve për të anketuarit/intervistuarit.** Të anketuarve u sigurohen të gjitha dokumentet e nevojshme (p.sh. letrat, pyetësorët, broshurat sidomos në rast të pyetësorëve që duhet ti mbushin ata vetë, dhe, nëse është e mundur, shpjegimet). Këto dokumente rishikohen në baza të rregullta.
4. **Procedura për monitorimin e teknikave të grumbullimit të të dhënave.** Teknikat e grumbullimit të të dhënave monitorohen në mënyrë periodike.

5. **Trajnimet për intervistuesit.** Mbahen trajnime për intervistuesit. Për secilën anketë, ekziston një manual për intervistuesit.
6. **Procedurat për trajtimin e mos-përgjigjeve.** Ekzistojnë dhe implementohen procedurat përkatëse, në rast të mos-përgjigjes.
7. **Metodat e kodimit të dhënave.** Metodat e kodimit të të dhënave dokumentohen dhe ruhen.
8. **Rishikimi automatik i metodave të kodimit.** Metodat e kodimit automatik rishikohen në mënyrë periodike, nëse është e nevojshme.
9. **Indikatorët e cilësisë në raport me grumbullimin dhe kodimin e të dhënave.** Janë zhvilluar indikatorët e cilësisë në raport me grumbullimin dhe kodimin e të dhënave, dhe analizohen sipas një plani të sigurimit të cilësisë, ose një skeme tjetër të ngjashme.
10. **Përkrahja e të anketuarve.** Të anketuarit ndihmohen në lidhje me plotësimin e pyetësorit (ndihmë on-line, thirrje në një numër pa pagesë, përkrahje nga statisticienët). Janë vendosur procedurat për t'iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të të anketuarve.

Indikatori 8.5: Përdoren metoda të përshtatshme editimi dhe imputimi dhe të njëjtat rishikohen ose përditësohen, sipas nevojës.

Metodat në nivel institucional

1. **Struktura organizative për udhëzuesit, metodologjitë dhe analizimi i metodave të përdorura.** Ekziston një strukturë e përshtatshme organizative, që ofron udhëzime, rekomandon metodologji të përshtatshme dhe analizon në mënyrë periodike metodat e editimit dhe imputimit.
2. **Promovimi dhe ndarja e procedurave për editim dhe imputim.** Janë promovuar dhe janë ndarë procedurat për teknikat e editimit dhe imputimit, për të inkurajuar harmonizimin e tyre.

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Analizimi i editimit dhe imputimit.** Analizimi i efektit të editimit dhe imputimit bëhet si pjesë e vlerësimit të cilësisë së grumbullimit të të dhënave.
4. **Përputhshmëria e teknikave të editimit dhe imputimit me standardet.** Teknikat e editimit dhe imputimit iu përmbahen rregullave standardeve metodologjike, dhe të njëjtat dokumentohen.

Indikatori 8.6: Rishikimet bëhen sipas procedurave standarde, mirë të rregulluara dhe transparente.

Metodat në nivel institucional

1. **Udhëzuesit dhe parimet në lidhje me rishikimet.** Ekzistojnë udhëzuesit dhe parimet në lidhje me rishikimin e statistikave të publikuara, të cilat janë aplikohen rregullisht dhe janë të njohura për përdoruesit.
2. **Promovimi i përmirësimeve metodologjike.** Përmirësimet e metodologjisë promovohen përmes veprimeve të rregullta dhe të përhershme (p.sh. seminarët mbi metodologjinë, takimet e ekspertëve, vetë-vlerësimet, auditimet etj.).

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Shpjegimet dhe publikimet e rishikimeve.** Rishikimet shoqërohen me të gjitha shpjegimet e nevojshme dhe janë në dispozicion për përdoruesit.
4. **Indikatorët e cilësisë mbi rishikimet.** Indikatorët e cilësisë mbi rishikimet e bëra kalkuloohen rregullisht sipas standardeve aktuale dhe bëhen të ditura për përdoruesit.

Indikatori 8.7: Autoritetet statistikore janë të përfshira në dizajnin e të dhënave administrative, në mënyrë që të dhënat administrative të jenë më të përshtatshme për qëllime statistikore.

Metodat në nivel institucional

1. **Procedura për monitorimin e akteve, rregulloreve/ligjeve në lidhje me të dhënat administrative.** Ekziston një procedurë për monitorimin e zhvillimeve në lidhje me aktet, rregulloret/ligjet, që përfshijnë përdorimin e të dhënave administrative.
2. **Konsultimi dhe përfshirja e autoritetit statistikor.** Autoriteti statistikor konsultohet kur krijohen, rishikohen ose ndryshohen formularët administrativë, si dhe përfshihet në ndryshimet e dizajnit ose procesimit, me qëllim të vlerësimit të vazhdimësisë së serive të të njëjtave.
3. **Procedura për hulumtimin e potencialit të burimeve administrative.** Ekziston një procedurë për hulumtimin e potencialit të burimeve të të dhënave administrative për qëllime statistikore.

Metodat në nivel produkti/ankete

4. **Diskutimet dhe takimet me pronarët e të dhënave administrative.** Mbahen diskutime ose takime të rregullta në mes të autoritetit statistikor dhe pronarëve të të dhënave administrative, me qëllim që të jenë të informuar në lidhje me amandamentet e të dhënave administrative (përmbytjet, procesin e prodhimit etj.).

Indikatori 8.8: Janë arritur marrëveshje me përgjegjësit e të dhënave administrative të cilët janë të përkushtuar ndaj përdorimit të këtyre të dhënave për qëllime statistikore.

Metodat në nivel institucional

1. **Marrëveshjet me përgjegjësit e të dhënave administrative.** Janë bërë marrëveshje në mes të autoriteteve statistikore dhe përgjegjësve të të dhënave administrative, për të lehtësuar përdorimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore.

Metodat në nivel produkti/ankete

2. **Dokumentimi në lidhje me të dhënat administrative.** Dokumentimi në lidhje me përmbytjen e të dhënave administrative dhe procesin e prodhimit të të dhënave (si dokumentacioni mbi metodologjinë, konceptet dhe definicionet, popullacioni) është në dispozicion të autoritetit statistikor.
3. **Marrëveshje e përbashkët me përgjegjësit e të dhënave administrative.** Marrëveshjet e përbashkëta në lidhje me sigurinë e të dhënave, ofrimin e të dhënave individuale dhe afatet kohore për sigurimin e të dhënave, janë zhvilluar bashkarisht nga autoriteti statistikor dhe përgjegjësit e të dhënave administrative.

Indikatori 8.9: Autoritetet Statistike bashkëpunojnë me pronarët e të dhënave administrative, për të siguruar të dhëna cilësore.

Metodat në nivel institucional

1. **Informimi i pronarëve të të dhënave administrative.** Pronarët e të dhënave administrative informohen në lidhje me të dhënat administrative që përdoren për qëllime statistikore dhe në lidhje me çështjet e cilësisë.
2. **Vlerësimi i cilësisë së të dhënave administrative.** Autoriteti statistikor sigurohet që marrëveshjet jetësohen dhe, kur është e mundur, ofron mjete për vlerësimin e cilësisë të dhënave administrative, duke respektuar konfidencialitetin.

Parimi 9: Ngarkesa jo e tepruar mbi të anketuarit

Ngarkesa për të ofruar të dhëna është në përputhje me nevojat e përdoruesve dhe nuk është e tepërt për të anketuarit. Autoritetet statistikore monitorojnë ngarkesën e të anketuarve dhe vendosin qëllime për reduktimin e saj me kalimin e kohës

Indikatori 9.1: Gama dhe detajet e kërkesave të Statistikave Evropiane është e kufizuar në atë, që është absolutisht e nevojshme.

Metodat në nivel institucional

1. **Prioritetet për Statistikat Evropiane.** Prioritetet për Statistikat Evropiane janë vendosur në nivel të SSE, duke pasqyruar nivelin e ngarkesës së të anketuarve.
2. **Verifikimi i ngarkesës të anketuarit dhe niveli i detajeve.** Bëhet analizimi i rregulloreve të BE-së mbi statistikën Evropiane, me qëllim të verifikimit të ngarkesës së të anketuarve dhe niveli i variablave të kërkuara, i paraparë me rregullore.
3. **Vlerësimi i programit të punës statistikore.** Autoriteti statistikor vlerëson përmbajtjen e programit statistikor për të eliminuar dyfishimet ose përsëritjet.

Metodat në nivel produkti/ankete

4. **Analizimi i nevojave për informacionet statistikore.** Nevojat Evropiane dhe kombëtare për informata statistikore dhe niveli i detajeve sipas fushave, analizohet gjatë fazës së Specifikimit të Nevojave në kuadër të procesit të prodhimit statistikor.
5. **Matja e ngarkesës së të anketuarve.** Ngarkesa e të anketuarve matet në mënyrë periodike.
6. **Justifikimi i secilit variabël të zgjedhur.** Secili variabël i zgjedhur justifikohet siç duhet.
7. **Marrja në konsideratë e burimeve alternative të të dhënave.** Për të minimizuar grumbullimin e të dhënave, merren në konsideratë burime alternative të të dhënave, përfshirë disponueshmërinë dhe përshtatshmërinë e anketave ekzistuese dhe dhënat administrative që janë në dispozicion.

Indikatori 9.2: Ngarkesa për të raportuar të dhëna shpërndahet sa më gjerë që është e mundur në popullacionin e anketës.

Metodat në nivel institucional

1. **Rishikimet e ngarkesës për të raportuar të dhëna.** Bëhen rishikime në baza të rregullta të të ngarkesës për raportim të të dhënave.
2. **Planet vepruese për thjeshtësim/modernizim.** Janë zhvilluar, implementohen dhe monitorohen planet vepruese për thjeshtësim/modernizim të proceseve, për të ulur ngarkesën e të anketuarve.
3. **Indikatorët e performancës mbi ngarkesën e të anketuarve.** Janë zhvilluar dhe analizohen në mënyrë periodike indikatorët e performancës mbi ngarkesën e të anketuarve, nga menaxhmenti i lartë.
4. **Përdorimi i metodave të mostrës statistikore.** Përdoren metoda statistikore të mostrimit, për t'u siguruar që ngarkesa për raportim të dhënash nuk bie mbi kategori të caktuara të të anketuarve, në mënyrë të panevojshme.

Metodat në nivel produkti/ankete

5. **Reduktimi i ngarkesës për raportim të dhënash.** Ngarkesa e të anketuarve është reduktuar përmes dizajneve të përshtatshme të mostrave, duke përdorur për shembull mostrën e koordinuar.
6. **Kalkulimi i ngarkesës për raportim të dhënash.** Ngarkesa për raportim të dhënash kalkulohet për kohën e nevojshme: për të plotësuar pyetësonin, për të marrë informatat e nevojshme, për të marrë ekspertizën e brendshme ose të jashtme dhe për të menaxhuar informatat sensitive.
7. **Kufizimi i pyetjeve.** Pyetjet që përdoren për të mbledhur informata, që nuk do të publikohen, janë të kufizuara dhe të justifikuara.

Indikatori 9.3: Informatat e kërkuara nga bizneset janë, aq sa është e mundur, të gatshme në pasqyrat e tyre, dhe, ku është e mundur, përdoren mjetet elektronike për marrjen e tyre.

Metodat në nivel institucional

1. **Manualet dhe mjetet teknike.** Manualet dhe mjetet teknike (p.sh. softveri) janë zhvilluar me qëllim të rritjes së mundësive elektronike për grumbullimin e të dhënave.
2. **Plani për grumbullimin e të dhënave elektronike për bizneset.** Ekziston një plan për grumbullimin e të dhënave elektronike për bizneset.
3. **Webfaqja për grumbullimin e të dhënave për bizneset.** Ekziston një webfaqe e përbashkët për grumbullimin e të dhënave të bizneseve.

Metodat në nivel produkti/ankete

4. **Përdorimi i sistemeve të kontabilitetit të bizneseve dhe sistemet e TI-së.** Sistemet e kontabilitetit të bizneseve dhe sistemet standarde të TI-së, siç është XBRL, përdoren në grumbullimin e të dhënave nga bizneset.
5. **Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit.** Menaxherët e anketave janë të vetëdijshëm për vështirësit potenciale në mbledhjen e informacioneve, bashkëpunojnë ngushtë me bizneset për të gjetur një zgjidhje adekuate.

6. **Mjetet për nxjerrjen e të dhënave nga sistemet e kontabilitetit të bizneseve.** Ekzistojnë mjetet softverike për të nxjerrë direkt të dhëna nga sistemet e kontabilitetit të bizneseve.
7. **Informimi i bizneseve në lidhje me rezultatet e anketës.** Për t'i falënderuar për pjesëmarrjen e tyre në anketë dhe për të promovuar rëndësinë e tyre në Sistemin Statistikor, bizneset duhet të informohen në lidhje me rezultatet e anketave.

Indikatori 9.4: Burimet administrative përdoren, sa herë që është e mundur, për t'iu shmangur disa kërkesave për informacione.

Metodat në nivel institucional

1. **Mjetet për rritjen e përdorimit të burimeve administrative.** Rrjetet evropiane bashkëpunuese kanë zhvilluar mjete për të rritur përdorimin e të dhënave administrative.
2. **Planet për shqyrtimin dhe përdorimin e burimeve administrative.** Janë zhvilluar veprime planifikimi në nivel kombëtar me qëllim të hulumtimit dhe përdorimit të burimeve administrative për nevoja statistikore (p.sh. marrëveshjet, zhvillimi i moduleve për përdorim në mënyrë të koordinuar duke reduktuar/limituar ngarkesën e të anketuarve, legjislacioni ose marrëveshjet në nivel vendi, nëse është e nevojshme).
3. **Obligimi ligjor për të ofruar të dhënat administrative.** Ekziston qasja ligjore në të dhënat administrative dhe autoritet administrative janë të obliguara të ofrojnë të dhënat administrative, nëse u kërkohet.

Metodat në nivel produkti/ankete

4. **Udhëzuesime mbi disponueshmërinë dhe cilësinë e burimeve të dhënave administrative.** Ekzistojnë udhëzime mbi disponueshmërinë dhe cilësinë e burimeve administrative për menaxherët e anketave.
5. **Aplikacionet për grumbullimin e të dhënave administrative.** Janë zhvilluar dhe implementohen aplikacionet për grumbullimin e të dhënave administrative, që përdoren për qëllime statistikore.

Indikatori 9.5: Të dhënat shpërndahen brenda autoriteteve statistikore me qëllim të shmangies së dyfishimit të anketave.

Metodat në nivel institucional

1. **Mjetet teknike për shpërndarjen e të dhënave.** Ekzistojnë mjetet teknike për shpërndarjen e të dhënave brenda Sistemit Statistikor Kombëtar (p.sh. marrëveshjet formale, shërbimet përmes webfaqes, bazat e zakonshme të të dhënave).

Metodat në nivel produkti/ankete

2. **Dokumentimi mbi depot e të dhënave.** Ekziston dokumentimi mbi depot për prodhimin dhe arkivimin e të dhënave.
3. **Shpërndarja e arkivave të të dhënave.** Arkivet e të dhënave shpërndahen brenda autoriteteve statistikore, kur është e nevojshme, dhe është në pajtueshmëri me politikat e konfidencialitetit.

Indikatori 9.6: Autoritet statistikore promovojnë masat, që mundësojnë lidhjen e burimeve të të dhënave, me qëllim të reduktimit të ngarkesës për raportim të dhënash.

Metodat në nivel institucional

1. **Shpërndarja e variablave kyçe.** Autoriteti statistikor definon variablat kyçe që duhet të shpërndahen midis proceseve të të dhënave, sipas rregullave të konfidencialitetit.

Metodat në nivel produkti/ankete

2. **Dokumentacioni mbi strukturat e dosjeve të dhënave dhe formatet e transmetimit.** Ekziston dokumentacioni i strukturave të dosjeve të të dhënave dhe formatet e transmetimit të nevojshme për lidhjen e burimeve të të dhënave.

Parimi 10: Kost efektiviteti

Resurset përdoren në mënyrë efektive.

Indikatori 10.1: Masa të pavarura të brendshme dhe të jashtme monitorojnë autoritetet statistikore, në përdorimin e resurseve.

Metodat në nivel institucional

1. **Monitorimi dhe raportimi i indikatorëve të resurseve njerëzore dhe financiare.** Indikatorët e burimeve njerëzore monitorohen në mënyrë të centralizuar dhe raportohen në baza të rregullta të menaxhmenti.
2. **Alokimi i resurseve për proceset statistikore.** Sistemet e kontabilitetit mundësojnë alokimin e resurseve për proceset statistikore.
3. **Vlerësimi i burimeve njerëzore.** Burimet njerëzore vlerësohen në baza vjetore në përputhje me udhëzuesit institucionalë. Vlerësimi mbulon alokimin, performancën dhe nevojat e trajnimit të stafit.
4. **Anketat e opinionit të stafit.** Anketat e opinionit të stafit mbahen në baza të rregullta.
5. **Rishikimi i infrastrukturës së TI-së.** Infrastruktura e TI-së rishikohet rregullisht.
6. **Procedurat për kalkulimin e kostove të pritura.** Ekzistojn procedurat për kalkulimin e kostove të pritura për proceset statistikore.

Indikatori 10.2: Potenciali i produktivitetit të teknologjisë informative dhe të komunikimit optimizohet për grumbullimin, procesimin dhe diseminimin e të dhënave.

Metodat në nivel institucional

1. **Grumbullimi i resurseve, investimeve dhe identifikimi i potencialit të inovacionit/modernizimit.** TI e centralizuar dhe njësitë e metodologjisë sigurojnë bashkimin e resurseve, investimeve dhe identifikimin e potencialit për inovacion/modernizim.

2. **Arkitektura dhe strategjia e TI-së.** Ekziston një arkitekturë dhe strategji e përshtatshme e TI-së dhe azhurnohet në baza të rregullta.
3. **Politikat, procedurat dhe mjetet për promovimin e teknikave të procesimit automatik.** Ekzistojnë politikat, procedurat dhe mjetet për promovimin e teknikave automatike për marrjen e të dhënave, kodimin dhe validimin e tyre.

Metodat në nivel produkti/ankete

4. **Rishikimi i përdorimit të teknikave për procesim automatik.** Përdorimi i teknikave për procesim automatik rishikohet në baza të rregullta.

Indikatori 10.3: Bëhen përpjeke proaktive për të përmirësuar potencialin statistikor të të dhënave administrative dhe për të limituar përdorimin e resurseve në anketa direkte.

Metodat në nivel institucional

1. **Marrëveshjet me përgjegjësit e të dhënave administrative.** Marrëveshjet e përshtatshme (p.sh. Marrëveshjet mbi Shërbimet ose të përcaktuara me legjislacion në nivel vendi) janë nënshkruar me përgjegjësit e të dhënave administrative dhe përditësohen rregullisht. Autoriteti statistikor përpiqet të përfshihet në dizajnimin e formateve administrative për grumbullim të dhënash.
2. **Vlerësimi i burimeve të mundshme të të dhënave administrative.** Para se të lansohet një anketë e re, bëhet një vlerësim i burimeve të mundshme të dhënave administrative.

Metodat në nivel produkti/ankete

3. **Metodat e lidhjes dhe integritit të të dhënave.** Metodat e lidhjes dhe integritit të të dhënave bëhen duke pasur në konsideratë sigurinë e të dhënave.
4. **Indikatorët e cilësisë për përmirësimin e përdorimit të të dhënave administrative.** Janë zhvilluar dhe përpiluar indikatorët e cilësisë, për të përmirësuar metodat e përdorimit të të dhënave administrative për qëllime statistikore.

Indikatori 10.4: Autoritetet statistikore promovojnë dhe implementojnë programe të standardizuara , që e rrisin efikasitetin dhe efektivitetin.

Metodat në nivel institucional

1. **Programet dhe procedurat e standardizimit për proceset statistikore.** Programet dhe procedurat e standardizimit janë definuar dhe implementuar në fazat kryesore të fushave të prodhimit statistikor, për shembull mostra, regjistrat, grumbullimi i të dhënave dhe shkëmbimi i të dhënave, sipas modelit të procesit të prodhimit statistikor.
2. **Strategjia për adaptimin ose zhvillimin e standardeve.** Ekziston një strategji për adaptimin ose zhvillimin e standardeve në fusha të ndryshme p.sh. menaxhimi i cilësisë, modelimi i procesit, zhvillimi i softverit, menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i dokumentimit.

Metdoat në nivel produkti/ankete

3. **Deklarata në dokumentacioni mbi metodologjinë.** Ekziston një deklaratë, që shpjegon hapat e ndërmarrë për të lëvizur gradualisht drejt standardizimit, si pjesë e metadave përkatëse.

Produkti statistikor

Statistikat që janë në dispozicion i plotësojnë nevojat e përdoruesve. Statistikat janë në përputhje me standardet Evropiane të cilësisë dhe i shërbejnë nevojave të institucioneve Evropiane, qeverive, insitucioneve hulumtuese, bizneseve dhe publikut në përgjithësi. Çështjet e rëndësishme janë shkalla në të cilën statistikat janë relevante, të sakta dhe të besueshme, të prodhuara në kohë, koherente, të krahasueshme nëpër regjione dhe vende, dhe me qasje të lehtë përdoruesit.

Parimi 11: Relevanca

Statistikat Evropiane plotësojnë nevojat e përdoruesve.

Indikatori 11.1: Ekzistojnë proceset e konsultimit me përdoruesit, monitorimit të relevancës dhe shfrytëzueshmërisë së statistikave ekzistuese, me qëllim të plotësimin të nevojave të tyre marrjes parasysh të nevojave dhe prioriteteve të reja.

Metodat në nivel institucional

1. **Legjislacioni mbi konsultimet me përdoruesit.** Ligji statistikor (Kombëtar dhe Evropian) përfshin obligimin për t'i konsultuar përdoruesit.
2. **Aktivitetet e konsultimit me përdoruesit.** Ekzistojnë aktivitetet e rregullta dhe të strukturuar për konsultimet me përdoruesit, përfshirë për shembull Këshillin e Përdoruesve, në lidhje në përmbajtjen e programit statistikor, si dhe dhe cilësinë e produkteve statistikore.
3. **Analizimi i të dhënave mbi përdorimin e statistikave.** Analizohen të dhënat mbi përdorimin e statistikave (p.sh. analizimi i shkarkimeve, abonentët e raporteve) për të ndihmuar përcaktimin e prioriteteve dhe konsultimin me përdoruesit.

Metodat në nivel produkti/ankete

4. **Klasifikimi i përdoruesve.** Përditësohet rregullisht klasifikimi i përdoruesve të produkteve të caktuara dhe është në dispozicion.
5. **Lista e përdoruesve kyç dhe të dhënat që ata përdorin.** Ekziston një listë e përdoruesve kyç dhe të dhënat që ata i përdorin, përfshirë listën e nevojave të paplotësuara të përdoruesve, e cila rregullisht përditësohet dhe është në dispozicion.
6. **Procedurat e konsultimit me përdoruesit.** Ekzistojnë procedurat për konsultimet me përdoruesit mbi statistikatat.
7. **Matjet dhe vlerësimet e rëndësishme.** Indikatori(ët) e cilësisë mbi relevancën vlerësohen në baza të rregullta.

Indikatori 11.2: Nevojat prioritare plotësohen dhe kjo reflektohet në programin e punës.

Metodat në nivel institucional

1. **Prioritetet e programit punues.** Ekzistojnë procedurat për të përcaktuar prioritetet midis nevojave të përdoruesve të ndryshëm.
2. **Qëllimet strategjike dhe planet e programit.** Janë vendosur qëllimet strategjike dhe planet e programit dhe të njëjtat publikohen në baza të rregullta.
3. **Marrëveshjet me përdoruesit më të rëndësishëm.** Janë arritur marrëveshjet në nivel shërbimi ose marrëveshje të ngjashme me përdoruesit më të rëndësishëm.
4. **Vlerësimi i programit të punës.** Bëhet një vlerësim periodik i programit të punës, për të identifikuar prioritetet negative dhe nevojat e reja.

Indikatori 11.3: Kënaqshmëria e përdoruesve monitorohet në baza të rregullta dhe përcillet në mënyrë sistematike.

Metodat në nivel institucional

